

Në bazë të nenit 14 paragrafi 2 dhe 3, nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune – teksti i pastruar (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 167/2015), nenit 20 – g të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/14 dhe 199/14), dhe në lidhje me Planin vjetor nr. 04-436/1 të datës 23.02.2018, dhe mendimit të pranuar pozitiv për Planin për punësime gjatë vitit 2018 me nr. 12/6 – 2283/7 të datës 20.04.2018, NP “Parqe dhe gjelbërime” – Shpall:

KONKURS PUBLIK me nr. 03/2018

për plotësimin e vendeve të punës në kohë të pa caktuar

1. NP “Parqe dhe gjelbërime” – Shkup ka nevojë për punësimin e:

Nr. rend.	Shifra	Emri i vendit të punës	Nr. i realizuesve
1	KDR.03.05.A01.038	Ndihmës drejtor për punët operative	1

2. Marrëdhënia e punës themelohet në kohë të pa caktuar të angazhimit punues.

3. Marrëdhënia e punës themelohet me orar të plotë të angazhimit punues.

4. Çdo kandidat duhet ti plotësojë këto kushte të përgjithshme:

- Të jetë nënshtrës i Republikës së Maqedonisë;
- Në mënyrë aktive të shfrytëzojë gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik;
- Të jetë i moshës së pjekur madhore;
- Të posedojë aftësinë e përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe
- Me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësorë të mos i jetë shqiptuar dënimi me ndalesë të ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

5. Kandidatët të cilët do të paraqiten për vendet e punës me numër rendor 1, duhet ti plotësojnë edhe kushtet e posaçme të parapara me LMP ose me Marrëveshjen kolektive për veprimtaritë komunale dhe kushtet e përcaktuara në Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në NP “Parqe dhe gjelbërime” – Shkup, përkatësisht:

Kushtet e posaçme të parapara me Ligjin për ndërmarrjet publike dhe me LMP ose Marrëveshjen kolektive për veprimtaritë komunale për ofruesit e shërbimit publik të kategorisë A janë:

Kualifikime profesionale së paku 240 kredi të fituara sipas EKTS ose të përfunduar nivelin VII/1;

- Përvojë pune, me sa vijon:

Për nivelin A1 së paku katër vite përvojë pune në profesionin, prej të cilave së paku dy vite në vende udhëheqëse pune në sektorin publik, përkatësisht së paku gjashtë vite përvojë pune në profesionin, prej të cilave së paku tre vite në vendin udhëheqës në sektorin privat.

Njohje aktive të programeve kompjuterike për punë kancelarie, përmes dorëzimit të vërtetimit.

Njohje aktive të një prej tre gjuhëve që më shpesh shfrytëzohen në Unionin Evropian (gjuhën angleze, frënge ose gjermane).

6. Orari i punës përfshin pesë ditë pune të javës (nga e hëna deri te premten) dhe do të llogaritet nga ora 7 deri në ora 15.
7. Neto paga themelore për këtë vend pune është në shumën prej 42.140,00 denarë për orar të plotë pune.
8. Kandidatët e interesuar për punësim, duhet të paraqiten në këtë konkurs publik përmes plotësimit të fletëparaqitjes. Fletëparaqitjen për punësim, kandidatët mund ta marrin në zyrat e ndërmarrjes publike ose në ueb faqen www.parkovi.com.mk.
9. Së bashku me fletëparaqitjen, kandidatët duhet të parashtrojnë edhe:
 - Biografi të shkurtër;
 - Dëshmi për nivelin e përfunduar të arsimit (diplomën në trajtë origjinale ose kopje e verifikuar te noteri);
 - Vërtetimin për nënshtetësinë e Republikës së Maqedonisë (në trajtë origjinale ose kopje e verifikuar te noteri);
 - Dëshmi se nuk iu janë shqiptuar dënimet për ndalesë të ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose të detyrës (në trajtë origjinale ose kopje e verifikuar te noteri).
10. Fletëparaqitjen së bashku me shtojcat duhet të dorëzohen personalisht në ndërmarrjen publike ose përmes postës në adresën vijuese: NP “Parqe dhe gjelbërime” – Shkup, bul. Ilinden nr. 104, 1000 Shkup.

Kontakt telefoni: 02/3070 112 , e-maili: covecki.resursi@parkovi.mk.com

Konkursi zgjat 5 (pesë) ditë, llogaritur nga dita e shpalljes së konkursit në shtypin ditorë.

Fletëparaqitjet e dorëzuara me vonesë dhe të plotësuar në mënyrë të parregullt, nuk do të jenë lëndë e shqyrtimit.

NP “Parqe dhe gjelbërime”

UD Drejtor

Ardijan Muça